

Fletë informative e thirrjes për veprim

Kriza përpara

Recensionin ekonomik që erdhi si pasojë e pandemisë "COVID-19" po ndikon në mënyrë të konsiderueshme në Rrethin Shkollor të Filadelfias (SDP). Shprehim vlerësim për veprimin e ndërmarrë kohëve të fundit nga Komonuellthi i Pensilvanisë për miratimin e një buxheti me të cilin ruhen nivelet aktuale të financimit për arsimin publik, por kjo nuk mjafton. Rrethi Shkollor vazhdon të përballet me një krizë financiare për shkak të humbjeve të të ardhurave lokale dhe kostove të reja të ndërlidhura me "COVID-19"-ën. Ekziston nevoja për më shumë financime për të mbrojtur investimet që kemi bërë gjatë pesë viteve të fundit, për të shtuar burimet dhe shërbimet e përkrahjes për nxënësit tanë.

Për fat të mirë, ligji "HEROES" do të ndihmonte në adresimin e shumë prej këtyre sfidave financiare të shkaktuara nga "COVID-19"-a. Nëse Senati i Shteteve të Bashkuara të Amerikës miraton ligjin "HEROES", ky ligj do të sigurojë 60 miliardë dollarë amerikanë si financim shtesë emergjent për shkollat e vendit tonë, duke përfshirë më shumë se 450 milionë dollarë për Rrethin tonë Shkollor, për të siguruar që nxënësit dhe personeli të jenë të shëndetshëm, të sigurt dhe në gjendje të zhvillojnë mësimin kur shkolla të fillojë përsëri në vjeshtë.

Çfarë na nevojitet tani nga ligjvënësit shtetërorë

Për të ndihmuar Rrethin Shkollor që të ruajë operacionet shkollore dhe të blejë furnizimet e nevojshme për mbështetjen e sigurisë dhe mirëqenies së të gjithë komunitetit të Rrethit tonë Shkollor, ne kemi nevojë që Senati i Shteteve të Bashkuara të Amerikës të miratojë ligjin "HEROES".

Mbajini nxënësit dhe personelin të shëndetshëm, të sigurt dhe të gatshëm për mësim.

Pandemia "COVID-19" ka pasur një ndikim të konsiderueshëm në buxhetin e Rrethit Shkollor. Senati i Shteteve të Bashkuara të Amerikës po shqyrton legjislacionin i cili do të ofronte lehtësimin e shumëpritur dhe do të sigurojë që financimi të jetë i disponueshëm për mbështetjen e distancimit social dhe të udhëzimeve shëndetësore, duke ofruar njëkohësisht edhe një përvijë arsimore rigoroze për nxënësit.

Kërkesa: Të miratohet ligji "HEROES".
T'u jepen shkollave të vendit 60 miliardë dollarë për t'i mbajtur nxënësit dhe personelin të shëndetshëm, të sigurt dhe të gatshëm për mësim.



Si mund të veproni?

Duke filluar nga 25 qershori, në Filadelfia, çdo e enjte do të jetë Ditë e Avokimit për Arsimin Publik. Le të ngremë zërin për t'u dëgjuar në Uashington D.C., çdo të enjte, deri në miratimin e ligjit "HEROES".

Merrni në telefon dhe dërgojuni email-e senatorit Toomey dhe senatorit Casey për t'i vënë në dijeni se mbështeteni te ta për fushatën **"Fund Our Schools!"**.

Bashkohuni me fushatën tonë në mediet sociale duke përdorur hashtagun #fundourschools për t'u kërkuar senatorëve tanë amerikanë në Uashington D.C. që të mbështesin fushatën **"Fund Our Schools!"**

Vizitoni faqen: philasd.org/fundourschools për të gjetur të dhënat e kontaktit të të gjithë zyrtarëve shtetërorë të zgjedhur, modelet e skenarëve dhe letrave si dhe më shumë hollësi lidhur me mënyrën se si duhet avokuar në Harrisburg për fushatën **"Fund Our Schools!"**